

**AKTI I THEMELIMIT  
I SHOQËRISË "A.F.L. Shoqëri Kooperative" sh.p.k.**

Sot, në Tiranë, më 29.07.2021, në përputhje me kërkesat e ligjit nr. 9901 datë 14.04.2008, "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare", i ndryshuar, u vendos hartimi i Aktit të Themelimit të shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar me Ortakët themelues:

1. **Cesare LIBERTI** lindur në Bari më 27 Prill 1964 dhe banues në Bari, në rrugën "De Rossi" nr. 121, me kod fiskal LBRC64D27A662L;
2. **Monica RONGA** lindur në Bari më 25 shkurt 1970, banuese në Bari-Loseto në rrugën "Monsignor Jolando Nuzzi" nr. 10, me kod fiskal RNG70B65A662C;
3. **Alessandro ROSSI** lindur në Taranto më 18 mars 1975 banues në Taranto në rrugën "Federico di Palma" nr 137/A me kod fiskal RSSLSN75C18L049C.
4. **Oliviero MASINI** lindur në Latina më 4 korrik 1972 banues në Sora (FR) në rrugën "Edoardo Facchini" nr 8/M me kod fiskal SMNLVR72L04E472V.

Të cilët hartojnë këtë Akt Themelimi për Shoqërinë "**A.F.L. Shoqëri Kooperative**" sipas ligjit 9901 datë 14.04.2008, "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare", i ndryshuar, ligjit 9723 datë 03.05.2007 "Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit", i ndryshuar, Kodit doganor, Kodit Fiskal, si vijon:

**KAPITULLI 1**

**Neni 1**

**Themelimi (Forma Ligjore)**

Shoqëria "**A.F.L. Shoqëri Kooperative**" sh.p.k. është subjekt i të drejtës juridike shqiptare, shoqëri me përgjegjësi të kufizuar (nga këtu e në vijim do të quhet "Shoqëria").

**Neni 2**

**Personaliteti Juridik**

Shoqëria fiton personalitetin juridik pasi të jetë regjistruar në Qendrën Kombëtare të Biznesit sipas kushteve dhe procedurave të parashikuara me ligj.

Shoqëria, pasi të ketë fituar personalitetin juridik, do të jetë përgjegjëse përballë palëve të treta në lidhje me detyrimet dhe dëmet e shkaktuara gjatë ushtrimit të aktivitetit të saj.

Shoqëria "**A.F.L. Shoqëri Kooperative**" sh.p.k., është një shoqëri, e themeluar nga Ortakë të cilët u përgjigjen humbjeve deri në limitin e vlerës së kontributit të tyre në kapitalin e shoqërisë

**Neni 3**

**Selia**

Shoqëria ka selinë në Tiranë, Pallati i Kulturës, Kati II

Shoqëria mund të ndryshojë selinë e saj, mund të hapë zyra përfaqësie, filiale, mund të krijojë filiale, si brënda ashtu edhe jashtë Republikës së Shqipërisë, vetëm me vendim të Asamblesë së Përgjithshme.

#### **Neni 4** **Objekti i Aktivitetit**

Shoqëria ka si objekt të aktivitetit të saj si vijon:

Magazininimin dhe / ose menaxhimin e depozitave, depove frigoriferike, dhe për llogari të palëve të treta, të të gjitha produkteve, duke përfshirë produktet medicinale, kimike, parafarmaceutike, dietetike, ushqim për kafshët, kozmetike dhe për qëllime shëndetësore dhe ushqimore;

Tregtim me shumicë dhe pakicë si të produkteve të veta ashtu edhe të koncensionareve dhe depove duke përfshirë gjithashtu import - eksport që lidhen me merceologjitë e mëposhtme: ushqimore, veshje, aparatura radiotelevizive, EË-FI, aparatura dhe materiale fotografike, artikuj kancelerie, makina llogaritëse elektronike me programe përkatëse, tekstile, parfumeri, lojra, lodra shtëpiake; konfeksioniste dhe/ose amballazhim, markim dhe etiketim, mbështjellje dhe ripaketim malli dhe përmbushje të të gjitha veprimeve plotësuese të tregtimit të produkteve si të vetat ashtu edhe të të tretëve; Pastrim banesash civile dhe/ose industriale ose tregtare ose publike;

Ofrim i shërbimit të ruajtjes, mbrojtjes ose vëzhgimit për ndërtesat private ose publike, fabrikave dhe kabanoneve industriale; - transport dhe autotransport kombëtar dhe ndërkombëtar të produkteve dhe mallrave për llogari të të tretëve; Dërgim, kombëtar dhe ndërkombëtar, i mallrave me mjete tokësore, detare, lumore, lagunare dhe ajrore; Automjete me qera me ose pa shofer. Dhënie me qera ose në përdorim e anijeve, avioneve, dhe e vagonave hekurudhor; Shërbimi i mbështetjes dhe ngritjes me vinça lëvizës, ngritës kamioni, ngritës, pirunë dhe shkallë vetëlëvizëse, transport për shkolla dhe për punë si dhe shpërndarje fizike e mallrave gjithashtu derë më derë, mbledhja e tyre nga klientët, dorëzimi të marrësi dhe të gjitha operacionet që lidhen me shpërndarjen.

Aktivitetet e përmendura në këtë objekt, do të kryhen në përputhje me rregulloret në fuqi në lidhje me ushtrimin e profesioneve të rezervuara për të cilat kërkohet regjistrimi në regjistra ose lista të veçanta.

Shoqëria mund të marrë pjesë në tendera publik ose privat në mënyrë direkte ose indirekte për zhvillimin e aktivitetit të përcaktuar në statutin aktual.

Kompania mund të kërkojë të aplikojë në të gjitha përfitimet publike (BE, shteti, rajone, ente lokale) të parashikuara në favor të bashkëpunimit, si dhe të të gjitha fondeve të rregulluara nga BE, entet publike, private dhe të veçanta, për sektorin në të cilin operon.

Për më tepër, brenda kufijve dhe sipas modaliteteve të parashikuara nga ligjet aktuale, kooperativa mund të kryejë çdo aktivitet tjetër të lidhur ose që është i ngajshëm me aktivitetet e listuara më sipër, si dhe të jetë në gjendje të kryejë të gjitha aktet dhe të përfundojë të gjitha veprimet lidhur me pasuri të paluajtshme, të luajtshme, tregtare, industriale, të nevojshme financiare dhe të dobishme për kryerjen e aktivitetit të shoqërisë ose gjithësesi të jenë në mënyrë direkte ose indirekte në linjë me aktivitetin e saj.

Kooperativa gjithashtu mund të marrë aksione në kompani të tjera për qëllime të investimeve të qëndrueshme dhe jo për vendosje në treg, veçanërisht nëse ato kryejnë veprimtari të ngjashme dhe në çdo rast ndihmëse me aktivitetin e shoqërisë, me përjashtimin absolut të mundësisë së kryerjes së aktivitetit që me ligji janë të

rezervuara për kooperativat të cilat përmbajnë kërkesa specifike, të autorizuara në mënyrë specifike dhe / ose të regjistruara në regjistrat ose listat specifike. Organi administrativ është i autorizuar të kryejë të gjitha aktivitetet e përmendura në kufijtë e përcaktuara për të.

Për më tepër, shoqëria për të stimuluar dhe favorizuar frymën e sigurimeve shoqërore dhe kursimeve të anëtarëve, mund të krijojë një pjesë të veprimtarisë, të drejtuar nga një rregullore specifike e miratuar nga Asambleja, për mbledhjen e kredive të kufizuara vetëm për anëtarët dhe të kryera ekskluzivisht për qëllime të arritjes së qëllimit të shoqërisë. Në çdo rast, përjashtohet, çdo aktivitet lidhur me mbledhjen e kursimeve nga publiku.

## **Neni 5** **Kohëzgjatja**

Kohëzgjatja e aktivitetit të shoqërisë "**A.F.L. Shoqeri Kooperative**" sh.p.k. do të jetë deri më 2050.

## **KAPITULLI 2** **KAPITALI**

### **Neni 6** **Kapitali themelues**

Kapitali i shoqërisë është 150 leke (njëqind e pesëdhjetë).

1. **Cesare LIBERTI** lindur në Bari më 27 Prill 1964 dhe banues në Bari, në rrugën "De Rossi" nr. 121, me kod fiskal LBRCSR64D27A662L, zotëron një kuotë e barabartë me vlerën prej 37.5 leke e cila përbën pjesën prej 25% të kapitalit
2. **Monica RONGA** lindur në Bari më 25 shkurt 1970, banuese në Bari-Loseto në rrugën "Monsignor Jolando Nuzzi" nr. 10, me kod fiskal RNG70B65A662C zotëron një kuotë e barabartë me vlerën prej 37.5 leke e cila përbën pjesën prej 25% të kapitalit
3. **Alessandro ROSSI** lindur në Taranto më 18 mars 1975 banues në Taranto në rrugën "Federico di Palma" nr 137/A me kod fiskal RSSLSN75C18L049C zotëron një kuotë e barabartë me vlerën prej 37.5 leke e cila përbën pjesën prej 25% të kapitalit.
4. **Oliviero MASINI** lindur në Latina më 4 korrik 1972 banues në Sora (FR) në rrugën "Edoardo Facchini" nr 8/M me kod fiskal SMNLVR72L04E472V zotëron një kuotë e barabartë me vlerën prej 37.5 leke e cila përbën pjesën prej 25% të kapitalit.

Pjesët e Kapitalit themelues nuk mund të përfaqësohen nga vlera të tregtueshme.

Kontributi i Ortakut mund të jetë i shprehur në lek ose në natyrë (pasuri e luajtshme/e paluajtshme ose të drejta).

Ortakut që mund t'i ndalohej ushtrimi i të drejtave që rrjedhin nga zoterimi i kuotës në shoqëri, gëzon të drejtën të kërkojë nga Gjykata lëshimin e një urdhër-ndalimi të shkeljes ose të kërkojë kompensimin e dëmit të shkaktuar si rezultat i shkeljes së këtyre të drejtave. Kjo e drejtë duhet ushtruar brenda 3 viteve nga momenti i shkeljes.

**Neni 7**  
**Mënyrat e transferimit të kapitalit**

Kuotat e kapitalit të një Shoqërie me përgjegjësi të kufizuar dhe e të drejtave që rrjedhin nga këto mund të blihen ose transferohen nëpërmjet:

- a) kontributit në kapitalin e shoqërisë,
- b) shitjes,
- c) trashëgimisë,
- d) dhurimit,
- e) çdo mënyre tjetër e parashikuar nga ligji.

Në rastin e transferimit të kuotave me anë të një kontrate, atëherë kjo kontratë duhet të hartohet me shkrim.

Statuti mund të kushtëzojë transferimin e kuotave, veçanërisht nëse cakton aprovimin ose të drejtën e parablerjes së shoqërisë në favor të shoqërisë ose të ortakëve të tjerë.

Në rastin e transferimit të kuotave me anë të një kontrate, të gjitha afatet, kushtet e transferimit të titullit të kuota, si dhe kushtet e transaksionit, përfshirë dhe momentin e pagesës së çmimit, rregullohen nga kjo kontratë. Kontrata e transferimit të kuotave hartohet me shkrim dhe njëhësi i këtij akti nga noteri nuk përbën kusht për vlefshmërinë ose regjistrimin e kontratës. Me përjashtim të rasteve kur ligji shprehet ndryshe ose të rasteve kur palët bien dakort në kontratë, vlefshmëria e transferimit të titullit të pronësisë mbi kuotat nuk është objekt ekzekutimi i formaliteteve të ndryshme me efekt deklarues, përfshirë këtu edhe formalitetet e regjistrimit ose të publikimit të kontratës ose të transferimit të titullit.

**KAPITULLI III**  
**ORGANET VENDIMMARRËSE DHE ADMINISTRUESE**

**Neni 8**  
**Organi Vendimmarrës**

Asambleja e Ortakëve është i vetmi organ vendimmarrës i shoqërisë.

Asambleja e Ortakëve është i vetmi organ vendimmarrës i shoqërisë që miraton ndryshimet në statut sipas menyrave të vendosura nga ligji.

Asambleja e Ortakëve është përgjegjëse për marrjen e vendimeve që kanë lidhje me çështjet e listuara në vijim:

- a) përcaktimin e politikave tregtare të shoqërisë;
- b) ndryshimet statutores;
- c) emërimin dhe heqjen e administratorëve;
- ç) emërimin dhe heqjen e likuidatorëve dhe të ekspertëve kontabël të autorizuar;
- d) përcaktimin e kompensimit për personat e përmendur në gërmat "c" e "ç" të kësaj pike;
- dh) mbikëqyrjen e zbatimit të politikave tregtare nga administratorët, përfshirë përgatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve lidhur me mbarëvajtjen e aktivitetit;
- e) miratimin e pasqyrave financiare vjetore si dhe të raporteve lidhur me mbarëvajtjen e aktivitetit;
- h) rritjen dhe zvogëlimin e kapitalit;
- f) ndarjen dhe anulimin e kuotave;

- g) përfaqësimin e shoqërisë në gjykatë ose në proçese të tjera përballë administratorëve;
  - gj) riorganizim dhe shpërbërje të shoqërisë;
  - h) caktimin e rregullave procedurale në lidhje me mbledhjet e asamblesë;
  - i) marrje kredie në çdo bankë ose institucion financiar.
  - j) çështje të tjera të parashikuara me ligj ose nga Statuti.
- Ortaku mund të jete i përfaqësuar në Asamblenë e Përgjithshme, nga një ortak tjetër ose nga një palë e tretë, me anë të një autorizimi.
- Administratori i shoqërisë nuk mund të ngarkohet si përfaqësues i ortakëve në Asamblenë e Përgjithshme.
- Autorizimi mund të lëshohet vetëm për një mbledhje të Asamblesë së Përgjithshme, e cila nënkupton edhe mbledhjet e tjera me të njëjtin rend dite.

## **Neni 9** **Administrimi**

Në përputhje me Statutin dhe Ligjin, shoqëria do të administrohet nga **Cesare LIBERTI** i lindur në Bari më 27 prill 1964 për një periudhë kohore prej pesë vjetësh me të drejtë rinovimi.

Asambleja e Përgjithshme me shumicë votash mund ti heqë administratorët në çdo moment. As statuti dhe as ndonjë marrëveshje tjetër nuk mund ta përjashtojnë osë ta kufizojnë këtë të drejtë.

Gjithashtu, administratorët mund të hiqen dhe me vendim gjykate me kërkesë të njërit nga ortakët, për dhunim të ligjit.

Të drejtat e përfaqësimit të administratorëve si dhe çdo ndryshim lidhur me ta, duhet të regjistrohen në Qendrën Kombëtare të Regjistrimit. Emërimi i administratorëve hyn në fuqi pas regjistrimit në Qendrën Kombëtare të Regjistrimit.

Administrator i shoqërisë mund të emërohet dhe një person që nuk është pjesë e ortakërisë.

## **Neni 10** **Kompetencat**

Administratori është i autorizuar dhe i detyruar të:

- a) përmbushë të gjitha aktet e administrimit të aktivitetit tregtar të shoqërisë, duke aplikuar politikat tregtare të vendosura nga Asambleja e Përgjithshme;
- b) përfaqësojë shoqërinë tregtare.
- c) ofrojë asistencën në mirëmbajtjen preçize dhe të rregullt të dokumentave dhe librave kontabël të shoqërisë.
- ç) përgatisë dhe të firmosë pasqyrat financiare vjetore, bilancin e konsoliduar, dhe raportet mbi mbarëvajtjen e aktivitetit dhe sëbashku me propozimet për shpërndarjen e fitimeve, duke i paraqitur këto dokumenta gjatë seancës së Asamblesë së Përgjithshme për aprovim;
- d) krijojë një sistem njoftimi në kohë për rrethanat që kërcënojnë mirëqenien e aktivitetit, dhe ekzistencën e shoqërisë.
- dh) ndjekë regjistrimet dhe të dërgojë të dhënat e detyrueshme të shoqërisë, siç përcaktoheët nga ligji për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit.
- e) ti drejtohet më parë Asamblesë së Përgjithshme në lidhje me aplikimin e politikave tregtare, dhe realizimin e veprimeve specifike të një rëndësie të veçantë për aktivitetin e shoqërisë tregtare.
- ë) kryejë detyra të tjera të përcaktuara nga ligji dhe nga statuti.

Administratori gëzon të drejtën të ndjekë të gjitha veprimet e zakonshme të administrimit. Administratori përfaqëson shoqërinë përpara të gjithë personave fizikë dhe juridikë, përpara autoriteteve publike dhe/ose private, kombëtare dhe të huaja, shqiptare ose të huaja, përfshi autoritetet gjyqësor të të gjitha niveleve, bankave të të gjitha niveleve, etj/.

Administratori gëzon fuqinë e veprimit në raport me palë të treta për llogari të shoqërisë, si dhe përpara bankave të të gjitha niveleve, për të kryer transferime, tërheqje etj., përballë zyrave tatimore, zyrave të administratës vendore, zyrave të punës, autoriteteve doganore etj., në të gjitha rrethanat, me përjashtim të kompetencave që ligji ia rezervon shprehimisht ortakëve të shoqërisë. Administratori përfshin shoqërinë në marrëdhënie më të tretë nëpërmjet akteve koerente me objektin e aktivitetit të saj.

### **Neni 11** **Viti Fiskal**

Viti fiskal i shoqërisë fillon me 1 janar dhe mbyllet me 31 dhjetor. Me përjashtim të vitit të parë i cili fillon në datën e regjistrimit të shoqërisë pranë Qendrës Kombëtare të Regjistrimit dhe mbyllet me 31 dhjetor.

### **Neni 12** **Baza Ligjore**

Shoqëria do të kryejë aktivitetin e saj në përputhje të plotë me këtë akt themelimi dhe dispozitat e legjislacionit shqiptar.

Për çdo çështje të pa përmendur në këtë akt, do të aplikohen dispozitat e ligjit "Për tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare", Kodi Civil dhe e çdo ligji tjetër specifik në Republikën e Shqipërisë.

### **Neni 13** **Mosmarrëveshjet**


Për të gjitha mosmarrëveshjet që mund të lindin nga zbatimi dhe interpretimi i këtij Akti Themelimi, gjithashtu për çdo mosmarrëveshje që mund të lindë midis shoqërisë dhe palëve të treta, kompetente për trajtimin e tyre do të jetë Gjykata Shqiptare.

### **Neni 14** **Dispozitat Përfundimtare**

Ky Akt Themelimi u hartua në 4 kopje me vlerë të njëjtë juridike, në gjuhën shqipe dhe italiane, u aprovua nen për nen nga Ortakët e Shoqërisë Tregtare "A.F.L. Shoqëri Kooperative" sh.p.k si dhe u firmos në të gjitha kopjet duke shkruar emër, mbiemër dhe firmën e njomë.

### **ORTAKËT THEMELUES** **TË SHOQËRISË "A.F.L. Shoqëri Kooperative" sh.p.k**


Monica Ronga (firmë);



Alessandro Rossi (firmë);



Oliviero Masini (firmë);



Liberti Cesare (firmë)

